

L I G J
Nr.8530, datë 23.9.1999

PËR SHËRBIMIN POSTAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
*(Ndryshuar me ligjin nr. 9223, datë 29.4.2004; nr. 10 132, datë 11.5.2009; nr. 10 361,
datë 16.12.2010)*
(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I

K R E U I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

1. Ky ligj rregullon ofrimin e veprimtarive postare, kushtet e kryerjes së shërbimeve postare, rolin e shtetit në sektorin postar, si dhe të drejtat dhe detyrat përkatëse të operatorëve dhe të përdoruesve.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

1. Sigurimi i ofrimit të shërbimit bazë postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Mbrojtja e interesave të përdoruesve dhe sigurimi i trajtimit të barabartë të tyre.
3. Nxitja e konkurrencës së lirë dhe efektive në ofrimin e shërbimeve postare.
4. Nxitja e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit.
5. Sigurimi i sekretit të korrespondencës dhe trajtimi konfidencial i të gjitha të dhënave për përdoruesin.

Neni 3
Përkufizime

*(Ndryshuar pika 14 dhe shtuar pikat 19 dhe 20 me ligjin nr. 9223, datë 29.4.2004;
ndryshuar pika 17 dhe shtuar pika 21 me ligjin nr. 10 132, datë 11.5.2009)*

Në kuptim të këtij ligji e në përputhje me terminologjinë ndërkombëtare në fushën e postave, sipas Glosarit të përcaktuar nga Bashkimi Postar i Përbotshtëm (UPU), termat e mëposhtme kanë kuptimin që vijon:

1. “Shërbime postare” kuptohen shërbimet e kryera kundrejt pagesës për transmetimin e objekteve të postës së letrave ose për transmetimin e kolive të adresuara, deri në një peshë 30 kg secila. Gjithashtu, “shërbime postare” quhen edhe shërbimet kundrejt pagesës, që sigurohen nëpërmjet mjeteve për transmetimin e objekteve postare.

2. “Shërbim bazë postar” kuptohet pranimi, përpunimi, vijimi dhe dorëzimi i objekteve të thjeshta të postës së letrave të adresuara, deri në 2 kg, i kolipostës së adresuar deri në 10 kg, shërbimi i urdhërpagesave postare dhe shërbimi për objektet e regjistruara dhe të siguruara. Për kolipostën e adresuar ndërkombëtare, që hyn nga shtete të tjere, kufiri i shërbimit bazë shtrihet deri në 20 kg.

3. “Objekte postare” kuptohet çdo lloj objekti, i transmetuar nga operatori postar (objekte të postës së letrave, koliposta, urdhërpagesa postare etj.).

4. “Transmetim” kuptohet çdo veprimtari e parashikuar për pranimin, përpunimin, vijimin dhe dorëzimin e objekteve postare tek i adresuari.

5. “Objekte të postës së letrave” kuptohen letrat, kartpostalet, shtypshkrimet, literatura për të verbërit, paketat e vogla.

6. “Objekte të thjeshta postare” kuptohet çdo objekt postar, që nuk shoqërohet me asnjë shërbim sigurimi, regjistrimi apo shërbime të tjera speciale.

7. “Shërbime speciale” kuptohen shërbimi i regjistrimit, i sigurimit dhe i regjistrimit, lajmërimarrja, posta ajrore, shërbimi ekspres, pagimi në çastin e dorëzimit, e prishshme, e thyeshme, për t’iu dorëzuar vetëm të adresuarit.

8. “Shërbime me vlerë të shtuar” kuptohen shërbimet e tjera nga shërbimet bazë dhe shërbimet speciale, si dhe shërbimet e reja, përmbushja e të cilave realizohet nga ofruesi i shërbimit, sipas rregullave të tij të biznesit.

9. “Posta direkte” kuptohet një komunikim që ka të bëjë vetëm me material reklame ose marketingu dhe që përmban një mesazh identik, me përjashtim të emrit, adresës apo të të dhënave të tjera, të cilat nuk e ndryshojnë natyrën e mesazhit dhe që i dërgohet një numri të ndjeshëm personash. Faturat, dëftespagesat dhe mesazhet e tjera joidentike nuk do të quhen postë direkte.

10. “Agjent postar” kuptohet një person, fizik ose juridik, i autorizuar për kryerjen e shërbimeve postare nga një ofrues i shërbimeve postare.

11. “Rrjet postar publik” kuptohet tërësia e lidhjeve teknike dhe të trafikut të zyrave të postës dhe të shërbimeve të transportit, vënë në interes të ofrimit të shërbimeve postare nga operatori publik i postave.

12. “Treg postar” kuptohet tregu i shërbimeve postare të siguruara kundrejt pagesës.

13. “Operator publik i postave” kuptohet çdo person juridik që i ofron publikut shërbimet bazë postare, sipas një marrëveshjeje që lidhet për këtë qëllim ndërmjet këtij personi juridik dhe Ministrit.

14. “Shërbime të rezervuara” nënkupton shërbimet e kryera ekskluzivisht nga operatori publik i postave, për të përmbushur detyrimin e shërbimit bazë për pranimin, përpunimin, transportin dhe dorëzimin e objekteve të korrespondencës së brendshme, me çmim dhe kufi peshe, siç përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave.

15. “Ofruesi i shërbimit” kuptohet çdo person juridik apo fizik, i cili i ofron publikut shërbime postare.

16. “Përdorues” kuptohet çdo person, fizik apo juridik, i cili përfiton nga ofrimi i shërbimeve postare si një dërgues ose i adresuar.

17. “Ministria” është ministria që mbulon veprimtarinë e shërbimeve postare”.

18. "Ministër" kuptohet ministri i ministrisë që mbulon veprimtarinë e shërbime postare.

19. "Licencë individuale" nënkupton të drejtën që i jepet çdo subjekti juridik, vendas ose i huaj, që plotëson kërkesat e legjislacionit shqiptar për shërbimet postare, për ofrimin e shërbimeve të tjera nga ato të rezervuara, që përfshihen në shërbimin bazë postar.

20. "Licencë e përgjithshme" nënkupton të drejtën që i jepet çdo subjekti fizik ose juridik, vendas apo i huaj, që plotëson kërkesat e legjislacionit shqiptar për shërbimet postare, për ofrimin e shërbimeve të tjera nga ato të rezervuara, që nuk përfshihen në shërbimin bazë postar.

21. "Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)" është organi rregullator, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ky ligj, nga ligji nr.9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", si dhe nga politikat e zhvillimit të fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 4

Përdorimi i shërbimeve postare

Të gjithë shtetasit, shqiptarë ose të huaj, rezidentë të përhershëm apo të përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, kanë të drejtë të përdorin shërbimet postare, në mënyrë të barabartë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 5

Shërbimi postar ndërkombëtar

Shërbimi postar ndërkombëtar rregullohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me konventat e organizatave ndërkombëtare, në të cilat është anëtarësuar Republika e Shqipërisë, me marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe, të lidhura ndërmjet Ministrisë dhe ofruesve të shërbimit.

KREU II

ROLI I SHTETIT NË SEKTORIN POSTAR

Neni 6

Roli i shtetit

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 132, datë 11.5.2009)

1. Ministri, nëpërmjet drejtorisë përgjegjëse për shërbimin postar, ndjek zbatimin e politikës së Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në sektorin e shërbimeve postare.

2. AKEP-ja mbikëqyr zbatimin e kuadrit rregullator, të përcaktuar nga ky ligj dhe nga politikat e Këshillit të Ministrave.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit e në këshillim edhe me AKEP-në e shoqatat e konsumatorëve, ndërmerr të gjitha vendimet e nevojshme për përmbushjen e objektivave të politikës së zhvillimit të shërbimeve postare.

Neni 7

Detyrat e ministrit

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 132, datë 11.5.2009)

Ministri, nëpërmjet drejtorisë përgjegjëse për shërbimin postar, ushtron këto detyra:

a) zhvillon politikën e sektorit postar, nëpërmjet strategjisë dhe parimeve të zhvillimit të shërbimeve postare, hapave e drejtimeve për zhvillimin e tregut dhe të infrastrukturës postare dhe detyrave, që lidhen me integrimin europian;

b) propozon në Këshillin e Ministrave aktet ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë veprimtaritë dhe shërbimet postare;

c) propozon në Këshillin e Ministrave masa, që sigurojnë kryerjen e shërbimit bazë postar;

ç) propozon marrëveshjen me operatorin publik të postave për detyrat dhe treguesit, që ai duhet të plotësojë për respektimin e detyrimeve për kryerjen e shërbimit bazë;

d) ushtron kontroll mbi veprimtarinë e operatorit publik të postave, për plotësimin e kushteve të marrëveshjes së lidhur, për sigurimin e shërbimit bazë;

dh) mbledh nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve, që i nënshtrohen këtij ligji, çdo informacion të nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të veta dhe i publikon ato informacione, që lidhen me ecurinë e përgjithshme të sektorit postar në Republikën e Shqipërisë;

e) përfaqëson Republikën e Shqipërisë në Bashkimin Postar të Përbotshëm (UPU) dhe në organizatat e strukturat europiane dhe rajonale, përgjegjëse për shërbimet postare, si dhe në nënshkrimin e traktateve e të marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e postave. Ndjek zbatimin e detyrimeve të sektorit postar, që rrjedhin nga traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat aderon apo është palë Republika e Shqipërisë;

ë) bashkëpunon me organet e pushtetit vendor për çështjet e shërbimit postar.

Neni 7/1

Kompetencat e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare

(Shtuar me ligjin nr. 10 132, datë 11.5.2009)

1. Për të përmbushur qëllimin dhe objektivat rregullatorë, të përcaktuar nga ky ligj, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ka këto kompetenca:

a) nxit zhvillimin e sektorit postar, duke zbatuar procedurat e licencimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) jep licencat, në bazë të përcaktimeve të këtij ligji dhe mbikëqyr respektimin e kushteve të licencave;

c) miraton procedurat, përmbajtjen, pagesat për licencat, për ushtrimin e veprimtarisë postare;

ç) kontrollon cilësinë e shërbimeve të ofruara nga operatorët dhe kërkon që ato të përputhen me standardet e caktuara;

d) kontrollon respektimin e zonës së rezervuar;

dh) harton dhe miraton standardet dhe kushtet teknike, në përputhje me rekomandimet e organizmave ndërkombëtarë;

e) kujdeset që konkurrenca ndërmjet operatorëve të postave dhe ofruesve të shërbimeve postare të mbështetet në parimet e transparencës, mosdiskriminimit dhe ndershmërisë;

ë) harton projektaktet normative, që rrjedhin nga ky ligj;

f) kërkon nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare të japin çdo lloj informacioni, që mund të jetë i nevojshëm për performancën e funksioneve të rregullimit,

duke garantuar ruajtjen e sekretit për informacionin e dhënë;

g) bashkëpunon për hartimin e kodit postar në Republikën e Shqipërisë;

gj) harton dhe adopton standarde për përcaktimin e densitetit të pikave të aksesit për rrjetet postare, me qëllim që ofrimi i shërbimit bazë (numri dhe densiteti) të jenë në përputhje me nevojat e përdoruesve;

h) harton metodologjinë e rregullimit të tarifave për shërbimin bazë, e cila, nëpërmjet ministrit, paraqitet për miratim në Këshillin e Ministrave;

i) përfaqëson Republikën e Shqipërisë në Organizatën Ndërkombëtare Rregullatore të Shërbimeve Postare;

j) përgatit dhe paraqet çdo vit, brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, në Kuvend raportin vjetor të veprimtarisë së vitit pararendës, i cili duhet të përmbajë detyrimisht:

i) një analizë të ofrimit të shërbimit bazë postar, me një vlerësim të cilësisë dhe të efikasitetit të shërbimit, situatës së shërbimeve të rezervuara;

ii) një analizë të tregut të shërbimeve postare dhe perspektivat e zhvillimit të tij;

iii) raportin e punës së AKEP-së për fushën e shërbimit postar.

2. Raporti publikohet në buletin e AKEP-së dhe në faqen e tij të internetit.

3. AKEP-ja ka detyrimin të informojë publikun dhe të drejtojë këshillime e diskutime të rëndësishme publike për çështjet e shërbimeve postare.

KREU III SHËRBIMET POSTARE

Neni 8

Objektet, veprimtaritë dhe shërbimet postare

(Shtuar pika 6 me ligjin nr. 10 132, datë 11.5.2009; shtuar pika 7 me ligjin nr. 10 361, datë 16.12.2010)

1. Objektet postare përfshijnë:

a) korrespondencën: letrat, kartpostalet, shtypshkrimet, mostrat, literaturën për të verbërit, paketat e vogla;

b) kolipostën;

c) telefaksin;

ç) urdhërpagesat.

2. Veprimtaria postare mbulon fushat e mëposhtme:

a) prodhimin, emetimin, vënien në qarkullim dhe tërheqjen nga qarkullimi të pullave postare dhe të objekteve të lidhura me to;

b) pranimin, përpunimin, vijimin dhe shpërndarjen e objekteve postare.

3. Veprimtaritë e përcaktuara në pikën 2 shkronja “a” të këtij neni, do të ushtrohen nga organi shtetëror, që e mbulon këtë veprimtari. Veprimtaritë e përcaktuara në pikën 2 shkronja “b” të këtij neni, do të ushtrohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji, në bazë të marrëveshjes, të licencës individuale apo të licencës e përgjithshme përkatëse.

4. Veprimtaritë postare të përcaktuara në pikën 2 shkronja “a” të këtij neni, të cilat ushtrohen rregullisht kundrejt një pagese, do të tarifohen si shërbime postare.

5. Përveç veprimtarive postare të paraqitura në pikën 2 të këtij neni, operatori publik i postave mundet, bazuar në kontratat përkatëse, të ushtrojë edhe veprimtari të tjera si:

a) shërbime financiare dhe bankare;

- b)veprimtari sigurimi;
- c) shërbim të transportit dhe të shpërndarjes së librave dhe të gazetave;
- ç) bashkëpunim në shërbimin telegrafik dhe të transmetimit të të dhënave me operatorët që ofrojnë këto shërbime;
- d) bashkëpunim në shërbimin telefonik publik nëpërmjet kabinave telefonike publike me operatorët që ofrojnë këto shërbime;
- dh) shërbimin e ndërmjetëm për qarkullimin e parave (kryerja e veprimeve bankare për llogari të të tretëve);
- e) transferim parash;
- ë) shërbime të tjera.

Veprimtaritë e sipërpërmendura mund të ushtrohen vetëm nëse ushtrimi i tyre nuk dëmton standardet e ofrimit të shërbimit bazë dhe nuk janë në kundërshtim me legjislacionin, që rregullon këto shërbime.

6. Operatori publik ka të drejtën e ngritjes së Postbankës, veprimtaria e së cilës rregullohet me akte ligjore dhe nënligjore të veçanta.

7. Operatori publik postar ka të drejtë të hapë llogari rrjedhëse dhe depozitë pa interes pranë Bankës së Shqipërisë. Afatet dhe kushtet për hapjen dhe funksionimin e llogarisë e të depozitës do të përcaktohen në marrëveshjen përkatëse, lidhur ndërmjet operatorit publik postar dhe Bankës së Shqipërisë.

Neni 9

Objekte që ndalohen të transmetohen nga posta

Ndalohet të transmetohen në rrugë postare objektet, përmbajtja e të cilave bie ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi ose me marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat shteti shqiptar është palë.

KREU IV

SHËRBIMI BAZË

Neni 10

Sigurimi i shërbimit bazë

1. Shërbimi bazë postar duhet t'i ofrohet çdo përdoruesi, në të gjithë territorin, me një çmim unik dhe të përballueshëm dhe me një cilësi të mirë. Shërbimi bazë postar duhet të sigurohet për çdo ditë pune, por jo më pak se 5 ditë në javë, me përjashtim të rrethanave ose të kushteve gjeografike, që gjykohen të veçanta nga Ministri.

2. Shërbimi bazë postar i ngarkohet operatorit publik të postave nga Ministri, në emër të shtetit dhe në bazë të marrëveshjes që lidh me të, siç përcaktohet në nenin 12 të këtij ligji.

3. Sigurimi i shërbimit bazë postar do të realizohet brenda 2 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 11

Shërbime të rezervuara

(Ndryshuar shkronja "b" e pikës 1 me ligjin nr. 9223, datë 29.4.2004)

1. Operatori publik i postave që të përmbushë detyrimin e shërbimit bazë postar, duhet që në mënyrë ekskluzive:

a) të autorizohet për prodhimin, emetimin, vënien në qarkullim dhe tërheqjen nga qarkullimi të pullave postare dhe të objekteve të lidhura me to;

b) të ketë të drejtën e transportimit të objekteve të thjeshta të postës së letrave të brendshme, në peshën që do të përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave. Këtu përfshihen dhe objektet e postës së drejtpërdrejtë.

c) të ketë të drejtën e vendosjes së kutive postare në vendet publike.

2. Bën përjashtim nga zona e rezervuar korrespondenca vetjake apo e biznesit, e cila shpërndahet vetë, pa pagesë dhe pa ndërmjetësinë e të tretëve.

3. Kushtet e nxjerrjes së pullave postare, veçanërisht rregullimet për hartimin e planit vjetor të nxjerrjes së pullave postare, përshkrimin, numrin e serive dhe karakterin e tyre, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

4. Kushtet e hollësishme të zbatimit, si dhe të drejtat dhe detyrat që rrjedhin nga dhënia e ekskluzivitetit, sipas pikës 1 shkronjave “b” dhe “c” të këtij neni, përcaktohen në marrëveshjen që Ministri lidh me operatorin publik të postave.

Neni 12

Rregullimi i operatorit publik të postave

1. Në marrëveshjen që lidhet ndërmjet Ministrit dhe operatorit publik të postave përcaktohen shërbimet e ofruara dhe detyrat e të drejtat e operatorit publik të postave për sigurimin e shërbimit bazë postar, që lidhen me të drejtat ekskluzive dhënë për këtë qëllim.

2. Marrëveshja lidhet me afat 20-vjeçar dhe rishihet çdo 4 vjet, me synimin për të pasqyruar ndryshimet që burojnë nga evoluimi i tregjeve postare dhe i kushteve të përgjithshme.

3. Në marrëveshjet do të trajtohen:

a) misioni dhe orientimet strategjike të operatorit publik të postave;

b) standardet e shërbimit dhe objektivat cilësore;

c) mënyrat dhe mjetet e kontrollit të kryerjes së shërbimit;

ç) publikimin e detajeve të shërbimit bazë postar për kushtet dhe pikat e aksesit, si dhe të dëndurisë në pranimin dhe shpërndarjen e objekteve postare;

d) procedurat e trajtimit të reklamacioneve;

dh) objektivat financiarë dhe treguesit e drejtimit;

e) parimet e vendosjes së tarifave për shërbimet e rezervuara (që lidhen me të drejtat ekskluzive të operatorit publik të postave), për shërbimet bazë postare dhe miratimi i tyre;

ë) mënyra e mbajtjes së llogarive për të siguruar transparencën e tyre;

f) plani i biznesit;

g) politika e investimeve dhe ajo kërkimore-shkencore;

gj) politika e zhvillimit të burimeve njerëzore;

h) kërkesat e bashkëpunimit teknik dhe të trafikut me ofruesit e tjerë të shërbimeve bazë postare, për të siguruar trajtimin jodiskriminues të tyre dhe për shlyerjet e detyrimeve reciproke;

i) të dhënat statistikore të veprimtarisë dhe periodiciteti i tyre.

4. Kur operatori publik i postave nuk përmbush kushtet e marrëveshjes, Ministri, pasi ka ndjekur gjendjen e ofrimit të shërbimit bazë postar dhe ka marrë të gjitha masat për mbështetjen e tij, duke përfshirë dhe ato të parashikuara në nenin 33 të këtij ligji, dhe me gjithë përpjekjet e tij nuk është arritur rezultati i pritshëm, ndërhyr në rishikimin e kushteve të marrëveshjes në afate më të shkurtra nga ato të parashikuara në pikën 2 të këtij neni. Përshkrimi i detajuar i masave të mësipërme do të bëhet në marrëveshjen që lidhet me operatorin publik të postave.

Neni 13

Bashkëpunimi në shërbimin postar

(Ndryshuar term me ligjin nr. 10 132, datë 11.5.2009)

1. Operatori publik i postave mund të përfitojë nga veprimtaria e një bashkëpunuesi (agjenti postar) për kryerjen e shërbimeve që i janë besuar atij.

2. Agjenti postar nuk mund të ushtrojë veprimtari të tjera jopostare, të cilat bien ndesh me kushtet për përmbushjen e veprimtarisë postare.

3. AKEP përcakton kushtet me plotësimin e të cilave, agjentit postar i jepet e drejta të përdorë shprehjet “postë” dhe “postare”.

Neni 14

Veprimtaritë e shërbimit

(Ndryshuar term me ligjin nr. 10 132, datë 11.5.2009)

1. Operatori publik i postave duhet të informojë publikun për shërbimet që ofrohen, orarin dhe standardet e shërbimit.

2. Rregullat e detajuara të ofrimit të shërbimit bazë postar nga operatori publik i postave përcaktohen në “Rregulloren e shërbimit bazë postar”, e cila miratohet nga drejtoria që mbulon shërbimet postare.

Neni 15

Situatat e jashtëzakonshme

(Shtuar pikat 3 dhe 4 me ligjin nr. 10 132, datë 11.5.2009)

1. Ministri, në bashkërendim me organet përkatëse, përcakton kushtet dhe procedurat për operimin e rrjeteve postare, si dhe ofrimin e shërbimeve postare, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, të shpallur sipas dispozitave përkatëse ligjore. Ministri mund të kufizojë ose të pezullojë përkohësisht ofrimin e shërbimeve bazë postare nga operatori publik i postave.

2. Në rastet e specifikuara në pikën 1 të këtij neni, asnjë ankesë për dëmshpërblim ose shlyerje detyrimi nuk mund të bëhet kundër operatorit publik të postave.

3. Operatorët postarë asistojnë për sigurimin e shërbimeve postare në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme.

4. Detyrimet e operatorëve postarë dhe kërkesat e kufizimet, të cilat janë të lidhura me sigurinë dhe mbrojtjen e vendit apo gjatë krizave joushtarake ose natyrore,

përcaktohen në licencat individuale.

KREU V
LICENCAT INDIVIDUALE DHE LICENCAT E PËRGJITHSHME
(Ndryshuar titulli me ligjin nr. 9223, datë 29.4.2004; ndryshuar titull me ligjin nr. 10
132, datë 11.5.2009)

Neni 16
Licencat individuale
(Ndryshuar term me ligjin nr. 9223, datë 29.4.2004)

1. Ofrimi i shërbimeve të tjera nga ato të rezervuara, por që përfshihen në shërbimet bazë postare, bëhet në bazë të një licence individuale që jepet nga AKEP-ja.
2. AKEP-ja përcakton procedurat e dhënies së licencave individuale, përmbajtjen e tyre, si dhe kushtet e modifikimit, të pezullimit dhe të revokimit të licencave individuale.
3. Dhënia e licencës individuale është e kushtëzuar me:
 - a) regjistrimin e pretenduesit si person juridik në gjykatë;
 - b) mungesën e pengesave ligjore për të ushtruar një veprimtari të tillë;
 - c) angazhimin e aplikuesit për përmbushjen e kërkesave themelore, që kanë të bëjnë me konfidencialitetin, sigurinë e rrjetit postar për mallrat e rrezikshme, mbrojtjen e të dhënave, si dhe të kërkesave të këtij ligji dhe të akteve të tjera, ligjore e nënligjore, përkatëse;
 - ç) detyrimin e tyre që të respektojnë të drejtat ekskluzive që i jepen operatorit publik të postave;
 - d) zotërimin e kushteve materiale dhe teknike, të domosdoshme për ofrimin e shërbimit.
4. Licenca individuale përfshin:
 - a) fushën për të cilën jepet (shërbimet që përfshihen dhe shtrirja gjeografike e tyre, rajonale apo kombëtare);
 - b) kohëzgjatjen e licencës individuale;
 - c) të dhëna mbi kushtet e ofrimit dhe treguesit cilësorë të shërbimit;
 - ç) të dhëna për mënyrat e kompensimit, në rastet e mospërmbushjes së shërbimit dhe trajtimi i reklamacioneve.
5. Licenca individuale mund të përfshijë edhe detyrime të shërbimit bazë postar, në rastet kur AKEP-ja e gjykon të nevojshme një gjë të tillë për sigurimin e këtij shërbimi.
6. Mosmiratimi i dhënies së licensës shoqërohet me shpjegimet përkatëse.

Neni 17
Licencat e përgjithshme
(Ndryshuar me ligjin nr. 9223, datë 29.4.2004; ndryshuar term me ligjin nr. 9223, datë
29.4.2004)

1. Shërbimet e tjera postare, që nuk përfshihen në shërbimin bazë postar, ushtrohen pas dhënies së licencës individuale së përgjithshme nga AKEP.
2. Procedura për dhënien e licencës së përgjithshme përcaktohet nga AKEP.
3. Një licencë e përgjithshme mund t'i jepet një personi fizik ose juridik, i cili:

a) plotëson kërkesat themelore të konfidencialitetit, të sigurisë dhe të mbrojtjes së të dhënave, si dhe respekton të drejtat ekskluzive që i jepen operatorit publik;

b) plotëson kërkesat e nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, për të ushtruar veprimtarinë postare.

4. Ofruesi i shërbimit është i detyruar të njoftojë AKEP për pezullimin dhe përfundimin e veprimtarisë së tij të paktën 30 ditë para marrjes së një veprimi të tillë.

5. Ofruesi i shërbimit duhet t'ia paraqesë tarifat për dijeni AKEP të paktën 15 ditë para vënies së tyre në zbatim, si dhe të japë çdo informacion, që i kërkohet nga ajo për kryerjen e funksioneve të saj.

6. Një ofrues i shërbimit, që ofron shërbimet në bazë të një licence individuale, sipas nenit 16 të këtij ligji, nuk ka nevojë për licencë të përgjithshme nga AKEP, siç parashikohet në këtë nen.

Neni 18

Kontrolli i shërbimeve postare

(Ndryshuar term dhe pika 7 me ligjin nr. 9223, datë 29.4.2004)

1. AKEP do të kontrollojë përmbushjen e shërbimeve postare sipas kërkesave të këtij ligji.

2. AKEP përcakton rregullat e detajuara për ushtrimin e kontrollit.

3. AKEP detyron personat, që ofrojnë shërbimin postar pa leje:

a) të ndërpresin ofrimin e shërbimit postar dhe të paguajnë gjobën përkatëse;

b) të nisin procedurat për marrjen e licencës së përgjithshme, nëse kërkon të vazhdojë veprimtarinë.

4. Nëse AKEP, gjatë kryerjes së kontrolleve vëren devijime të dispozitave të këtij ligji, shkelje të rregullave ligjore përkatëse, të kushteve të licencës individuale, të licencës së përgjithshme të dhe të rregullores së miratuar, të cilat nuk formojnë vepër penale, por përbëjnë kundërvajtje administrative, ajo duhet:

a) të vendosë gjobë dhe të kërkojë nga ofruesi i shërbimit të ndërpresë devijimin, duke vënë një kufi kohor për realizimin e tij;

b) të pezullojë veprimtarinë e ofruesit të shërbimit;

c) të marrë masa për tërheqjen e licencës së përgjithshme ose të propozojë revokimin e licencës individuale,

ç) të zbatojë sanksionet që parashikohen në dispozita ligjore të veçanta.

5. Në rastin kur licenca e përgjithshme tërhiqet në bazë të pikës 4 shkronja “c” të këtij neni nuk jepet leje e re për tre vjet nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit për tërheqjen.

6. Për rastet e kundërvajtjeve administrative mbahet procesverbal nga punonjësit e AKEP, të cilët propozojnë marrjen e njerës prej masave të parashikuara në pikën 4. Vendimi jepet nga Drejtori i AKEP.

7. Kundër vendimit të inspektorit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare mund të bëhet ankim në këshillin drejtues të AKEP-së brenda 10 ditëve nga data e vënies së gjobës. Këshilli drejtues merr vendim brenda 30 ditëve nga data e ankimit. Kundër vendimit të këshillit drejtues të AKEP-së mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit.

KREU VI KONTRATA E SHËRBIMIT POSTAR

Neni 19

Plotësimi i kushteve të kontratës

1. Në përputhje me kontratën e shërbimit postar, operatori publik i postave është i detyruar të pranojë, të përpunojë, të vijojë dhe të shpërndajë tek i adresuari çdo objekt postar që i përgjigjet kërkesave të paraqitura në dispozitat ligjore përkatëse, standardet dhe rregulloret e shërbimit. Operatori publik i postave mund të kundërshtojë plotësimin e kontratës vetëm në rastet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

2. Operatori publik i postave është i detyruar të refuzojë plotësimin e kontratës për çdo shërbim që përfshihet në fushën e veprimtarisë së tij nëse:

a) marrja përsipër e detyrimit bie ndesh me “Rregulloren e shërbimit bazë postar” apo me marrëveshjet ndërkombëtare;

b) përmbajtja e objektit në mënyrë të dukshme dëmton ose rrezikon jetën, shëndetin, tërësinë trupore ose mjedisin;

c) objekti nuk plotëson specifikimet, të cilat lidhen me objektet që i nënshtrohen shpërndarjes së kushtëzuar.

3. Objektet postare që përmenden në pikën 2 të këtij neni dhe kushtet e postimit të tyre do të përshkruhen dhe do të përcaktohen nga operatori publik i postave në rregulloret e tij të shërbimit. Gjithashtu, operatori publik i postave merr masat e duhura për publikimin e tyre.

4. Operatori publik i postave mund të mos pranojë të lidhë një kontratë nëse:

a) ofrimi i shërbimit është pezulluar ose kufizuar në përputhje me nenin 15 të këtij ligji;

b) për arsye që dalin jashtë sferës së veprimtarisë së tij, nuk zotëron kushtet e operimit të domosdoshëm për sigurimin e shërbimit.

5. Në pranimin e objekteve me vendmbërritje jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, operatori publik i postave është i detyruar të paralajmërojë dërguesin për ndonjë ndalim apo kufizim për importet, që është në fuqi në shtetin e mbërritjes të të adresuarit ose në shtetet tranzite e që ndikojnë në objektet në dalje.

Neni 20

Pranimi

1. Pranimi i një objekti ose marrja përsipër e një shërbimi nënkupton lidhjen e një kontrate ndërmjet operatorit publik të postave dhe përdoruesit.

2. Vendosja e një objekti në një kuti postare të instaluar nga ofruesi i shërbimit për këtë qëllim, ose në një pajisje tjetër, që i shërben po këtij qëllimi, është e barazvlefshme me pranimin e këtij objekti.

3. Pranimi një objekti të regjistruar (objekte të postës së letrave, të pranuar në përputhje me shërbimet speciale të regjistrimit, të regjistrimit dhe deklarimit të vlerës, koliposta, letra dhe koliposta të postuara me vlerë të deklaruar, telefaks dhe urdhërpagese) quhet i realizuar kur objekti merret në dorëzim nga operatori publik i postave, i cili, në të njëjtën kohë, i jep dërguesit një dëftesë pranimi.

4. Një letër dhe një kolipostë mund të postohet me një deklaratë të vlerës, e cila është e kufizuar në trafikun e brendshëm dhe të jashtëm, ndërkohë që, nëse objekti ka si vendmbërritje një shtet të huaj, deklarata e vlerës nuk mund të kalojë kufirin e përcaktuar nga vendi i mbërritjes dhe të bërë të njohur publikisht në rregulloret përkatëse.

5. Pranimi i parave për t'u dërguar me postë quhet i realizuar me marrjen në dorëzim të parave nga ofruesi i shërbimit dhe dhënien prej tij të pjesës së njoftimit të transferimit, i cili vërteton marrjen në dorëzim. Pjesa tjetër e njoftimit të transferimit, që i mbetet operatorit publik të postave, do të trajtohet si një objekt i regjistruar.

Neni 21

Detyrimi

1. Detyrimi për shërbimin postar duhet të paguhet, në përputhje me dispozitën përkatëse të rregullores së shërbimit, me anë të pullave postare, në një mënyrë tjetër të vërtetuar ose me para në dorë. Në rastet e specifikuara në rregulloret e shërbimit, detyrimi mund të paguhet me dorëzimin e objektit.

2. Objektet e postës së letrave të organeve shtetërore dhe të pushtetit gjyqësor, meqenëse janë dokumente zyrtare, mund të postohen si objekte të regjistruara, duke përdorur njoftimin e dorëzimit të hartuar për këtë qëllim, nëse, mbështetur në legjislacionin përkatës, marrja në dorëzim e dokumentit shërben si bazë për llogaritjen e një kufiri kohor, fillimi apo përfundimi i të cilit është subjekt i pasojave ligjore, në përputhje me ligjin.

3. Në rastin e mospërmbushjes së kontratës së shërbimit postar, përfshirë edhe humbjen e objektit, operatori publik i postave është i detyruar të kthejë detyrimin e paguar. Operatori publik i postave nuk është i detyruar të kthejë, në raste të tilla, detyrimin e paguar për objektet e thjeshta.

Neni 22

Vijimi

1. Operatori publik i postave është i detyruar të vijojë, në mënyrë të sigurtë, objektet e pranuar.

2. Operatori publik i postave është i lirë të zgjedhë rrugën dhe mënyrën e transportimit të objekteve, me përjashtim të postës ajrore, e cila duhet të vijohet si e tillë.

Neni 23

Dorëzimi

1. Objektet postare, me përjashtimin e bërë në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, duhet t'i dorëzohen të adresuarit në vendin e treguar nga dërguesi (më poshtë referohet: adresa). Në rastin e personave juridikë, përfaqësues i tyre autorizohet të marrë në dorëzimin objektet e adresuara për to.

2. I adresuari privat ose përfaqësuesi i përmendur në pikën 1 të këtij neni mund të autorizojë të tjerët për të marrë në dorëzim objektet postare.

3. Operatori publik i postave mund t'i dorëzojë një objekt të adresuar një personi privat, nëse dërguesi nuk ka dhënë ndonjë instruksion tjetër, një marrësi zëvendësues (një person i caktuar, i cili mund të marrë përsipër objektet për të adresuarin pa autorizim, duke patur të njëjtat të drejta si i adresuari) ose ta dorëzojë atë tërthorazi, siç përcaktohet në

pikën 4 të këtij neni.

4. Operatori publik i postave do t'ia dorëzojë një objekt postar në vend të të adresuarit një marrësi të autorizuar (dorëzim tërthor), duke shkarkuar përgjegjësinë në adresën e dhënë, e cila është ajo e një:

- a) njësie ushtarake;
- b) vendit të vuajtjes së dënimit dhe ato të edukimit;
- c) institucioni shëndetësor ose të përkujdesjes sociale;
- ç) hoteli, konvikti punonjësish ose studentësh;
- d) personi juridik.

5. Në vend të adresës së treguar nga dërguesi, një objekt mund të dorëzohet në zyrën e operatorit publik të postave, nëse:

- a) dërguesi ose i adresuari kanë dhënë instruksione të tilla;
- b) asnjë person i caktuar për të marrë objektet nuk është gjetur në adresën e treguar nga dërguesi;
- c) dorëzimi në adresë kufizohet nga natyra dhe përcaktimet për vlerën e disa lloje objektesh.

6. Një objekt i paregjistruar mund të dorëzohet, duke e vendosur atë në një kuti postare, private ose në një grup kutish të vëna në adresën e treguar.

7. Një objekt i regjistruar mund të dorëzohet duke përdorur kuti postare, në rastin kur ka dështuar përpjekja e parë për ta dorëzuar atë dhe, megjithëse operatori publik i ka lënë të adresuarit një njoftim për objektin në fjalë, përpjekja e përsëritur për të dorëzuar objektin në kohën e përcaktuar në njoftim, gjithashtu, nuk është realizuar.

Neni 24

Rastet kur objekti vlerësohet i padorëzueshëm

1. Një objekt quhet i padorëzueshëm nëse:

a) për shkak të arsyeve, që nuk varen nga operatori publik i postave, objekti, pasi është mbajtur për një muaj në dispozicion të marrësit, në përputhje me rregulloret e shërbimit dhe nuk është realizuar dorëzimi i tij marrësit, nuk mund të dorëzohet tek i adresuari ose të kthehet te dërguesi;

b) detyrimi për t'u paguar nuk ka qenë paguar as nga dërguesi, as nga marrësi.

2. Në rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, ofruesi i shërbimit është i detyruar të ruajë objektin deri në 1 vit nga data e postimit të tij.

3. Operatori publik i postave, në rastin kur nuk ka mundësi, gjatë periudhës së ruajtjes, të dorëzojë apo të kthejë objektin, atëherë, pas një viti, ai ka të drejtë:

a) të shesë objektin dhe të paguajë shumën e fituar në këtë mënyrë, pas zbritjes së detyrimit dhe shpenzimeve të veta, në përfitim të shtetit;

b) të paguajë shumën në fitim të shtetit, në rastin e parave të dërguara me postë;

c) të kthejë dokumentin e përfshirë në objekt, te hartuesi i tij;

ç) të asgjësojë objektin, nëse nuk shitet.

Neni 25

Marrëdhëniet me doganën

1. Operatori publik i postave do t'i paraqesë autoritetit doganor për inspektim, në

prani të përfaqësuesit të vet, objektet që vijnë nga jashtë dhe ato që dërgohen për jashtë dhe që janë objekt i kontrollit doganor.

2. Objektet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni që vijnë nga jashtë, do të vijohen nga ofruesi i shërbimit, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, në zyrën e doganës përkatëse, vendosja e së cilës përcaktohet me marrëveshje të veçantë me autoritetin doganor.

3. Operatori publik i postave do t'ia kthejë dërguesit objektet e papërshtatshme për zhdoganim, me përjashtim të rastit kur dërguesi jep instruksion tjetër ose rregullat doganore parashikojnë ndryshe.

Neni 26

Përgjegjësia për plotësimin e kontratës së shërbimit postar

1. Operatori publik i postave mban përgjegjësi për përmbushjen e kontratës së shërbimit postar, përfshi dëmtimin që i është shkaktuar objektit, mungesën e përmbajtjes, humbjen, si dhe vonesën e tij, në përputhje me rregullat e shërbimit, duke lejuar përjashtimet e bëra në këtë ligj.

2. Në trafikun ndërkombëtar do të zbatohen rregullat e marrëveshjeve ndërkombëtare, në të cilat është palë dhe Republika e Shqipërisë.

3. Në lidhje me pagesat nëpërmjet shërbimit të urdhërpagesave, brenda dhe jashtë vendit, operatori publik i postave mban përgjegjësi për atë shumë për të cilën provohet me dokumente, se nuk është kryer shlyerja.

4. Operatori publik i postave, në bazë të rregulloreve që mbulojnë fushën e veprimtarisë së tij ose nga dispozita të veçanta të kontratës, mund të marrë përsipër detyrime më të mëdha përgjegjësie.

5. Për dëmet e shkaktuara ndryshe nga ato që janë parashikuar në kontratë, sikurse dhe për dëmet e shkaktuara me qëllim, nga pakujdesia ose nga një akt kriminal, operatori publik i postave mban përgjegjësi në përputhje me dispozitat e Kodit Civil.

Neni 27

Rastet e përjashtimit nga përgjegjësia

1. Operatori publik i postave nuk mban përgjegjësi në fushën e shërbimit postar:

a) për ndonjë dëm si rezultat i dorëzimit të gabuar, humbjes, dëmtimit ose shkatërrimit të një objekti të thjeshtë postar;

b) nëse dëmi lidhet me karakteristika të brendshme, të cilat s'mund të shquhen nga jashtë, me paketim të papërshtatshëm ose rezulton nga një adresë e pamjaftueshme;

c) nëse dëmi është rezultat i një shkakut të pashmangshëm, që bie jashtë fushës së veprimtimit të ofruesit të shërbimit dhe do të ndodhte edhe po qe se objekti do të ishte në dorën e porositësit.

2. Në rastin e dorëzimit të rrezikshëm, dorëzimi i objektit kalon përgjegjësinë nga operatorin publik i postave te marrësi në dorëzim. Marrësi në dorëzim merr përsipër ndaj të adresuarit përgjegjësinë me të cilën ngarkohet dorëzuesi.

Neni 28
Masa e dëmshpërblimit

1. Operatori publik i postave është i detyruar të dëmshpërblejë për humbje të vlerës së një objekti vetëm në përputhje me specifikimet e paraqitura nga pika 2 deri në pikën 6 të këtij neni.

2. Operatori publik i postave është i detyruar të paguajë dëmshpërblim në rastin e humbjes ose të shkatërrimit:

- a) të letrave ose të kalipostave të siguruara;
- b) të objekteve të siguruara dhe të regjistruara të postës së letrave, të objekteve të regjistruara të postës së letrave, të telefaksit ose të kolipostës;
- c) të urdhërpagesave postare.

3. Në rastin e objekteve të përcaktuara në pikën 2 shkronja “a” të këtij neni, masa e përgjithshme e dëmshpërblimit do të jetë e barabartë me deklarin e vlerës, siç është treguar nga dërguesi. Kufiri maksimal i dëmshpërblimit, për çdo dëm të shkaktuar objekteve të përmendura në pikën 2 shkronja “a”, është i njëjtë si më sipër.

4. Në rastin e objekteve të përcaktuara në pikën 2 shkronja “b” të këtij neni, masa e përgjithshme e dëmshpërblimit do të përcaktohet në përputhje me “Rregulloren e shërbimit bazë postar”. Kufiri maksimal i dëmshpërblimit në rast dëmtimi të objekteve të përcaktuara në pikën 2 shkronja “b” të këtij neni, është e njëjtë si më sipër.

5. Në rastin e objekteve të përcaktuara në pikën 2 shkronja “c”, masa e dëmshpërblimit do të jetë e barabartë me vlerën e plotë të urdhërpagesës.

6. Për shërbimin ndërkombëtar masa e dëmshpërblimit do të përcaktohet në mbështetje me konventat ndërkombëtare dhe në përputhje me “Rregulloren e shërbimit bazë postar”.

Neni 29
Reklamacionet

1. Afati i ankimit për dëmshpërblim ndaj ofruesit të shërbimit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 26 pika 4 të këtij ligji, humbet për një vit duke filluar 15 ditë pas datës së postimit.

2. Operatori publik i postave mund të kërkojë pagimin e tarifës së shërbimit, sipas afatit të përcaktuar në kontratën e lidhur për sigurimin e këtij shërbimi.

KREU VII
KONFIDENCIALITETI

Neni 30
Ruajtja e sekretit

1. Ofruesi i shërbimit është i detyruar të ruajë sekretin e korrespondencës, sekretin individual, sekretin e veprimtarisë, që i bëhet i njohur gjatë përmbushjes së kontratës, si dhe kujdeset për trajtimin konfidencial të çdo informacioni vetjak.

2. Detyrimi i ruajtjes së sekretit është i njëjtë për ofruesin e shërbimit, për të gjithë punonjësit e tij, si dhe për çdo njeri tjetër që ka dijeni për sekretet individuale ose hollësitë

vetjake, si rezultat i shërbimit postar. Kur zbulohet dhunimi i një sekreti vetjak, personat përgjegjës mbajnë përgjegjësi në përputhje me dispozitat ligjore.

3. Detyrimi për ruajtjen e sekretit, siç përcaktohet në pikën 2 të këtij neni, do të zbatohet edhe pas përfundimit të shërbimit postar, si dhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve përkatëse të punësimit, ndërmjet ofruesit të shërbimit dhe punonjësit.

Neni 31

Mbrojtja e të dhënave

1. Bazuar në detyrimin për ruajtjen e sekretit, ofruesit të shërbimit, me përjashtimet e bëra në rastet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, i ndalohet:

a) të hapë një objekt postar të mbyllur ose të njihet me përmbajtjen e tij pa e hapur objektin;

b) t'u japë të tretëve të dhëna me të cilat ai është njohur gjatë përmbushjes së shërbimit, me përjashtim të dërguesit, të adresuarit dhe personit të caktuar për të marrë objektin në dorëzim;

c) ta dorëzojë objektin te të tretët, me qëllim njohjen e përmbajtjes së tij;

ç) të informojë të tretët rreth përmbushjes së shërbimit, përveç dërguesit, të adresuarit dhe personit të caktuar për të marrë objektin në dorëzim.

2. Ofruesi i shërbimit mund të hapë një objekt postar të mbyllur ose të shqyrtojë përmbajtjen e një objekti postar të hapur nëse:

a) për shkak të mungesës së adresës, objekti nuk mund të dorëzohet apo të kthehet dhe për dorëzimin është e nevojshme të njihet adresa e të adresuarit ose e dërguesit;

b) paketimi ose mbulimi i objektit është dëmtuar në atë masë që për t'u mbrojtur përmbajtja e tij, është i nevojshëm ripaketimi i cili nuk mund të bëhet pa hapjen e objektit;

c) është e nevojshme për të kontrolluar zbatimin e kërkesave për tarifën, në rastet e objekteve të transmetuara me tarifën e reduktuara;

ç) është e nevojshme për të parandaluar dëmtimin e personave ose të pronës.

3. Hapja e një objekti do të bëhet nga një komision, i cili është i detyruar të mbajë procesverbal për procedurën e hapjes dhe për masat që duhen marrë. Nëse nuk mund të ngrihet një komision i tillë, hapja mund të realizohet në praninë e një personi të pushtetit vendor. Fakti i hapjes duhet të tregohet mbi objekt, dhe, nëse është e mundur (për shembull, emri dhe adresa e dërguesit njihet), dërguesi duhet njoftohet për hapjen dhe për arsyet e kësaj hapjeje.

4. Ndalimet e parashikuara në pikën 1 shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të këtij neni, nuk do të zbatohen nëse veprimet e kryera në to janë të domosdoshme për ndjekjen e një kundërvajtjeje administrative ose të një vepre penale.

5. Në lidhje me konfiskimin, rezervimin apo sekuestrimin e objekteve postare do të zbatohen rregullat e Kodit të Procedurës Penale.

KREU VIII

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 32

Rastet e kundërvajtjeve

(Ndryshuar togfjalsh n pikn 5 me ligjin nr. 9223, datë 29.4.2004)

Dënohen si kundërvajtje administrative, të kryera nga një person fizik ose juridik kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e mëposhtme:

1. Transmetimi i objekteve postare pa licencë individuale apo pa licencë e përgjithshme, siç parashikohet në dispozitat e këtij ligji.

2. Mosrespektimi i kushteve të licencës individuale apo të licencës së përgjithshme, të parashikuara përkatësisht në nenet 16 dhe 17 të këtij ligji.

3. Shkelja e kërkesave të këtij ligji për konfidencialitetin, sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave.

4. Mosrespektimi i të drejtave ekskluzive të operatorit publik të postave, sipas parashikimeve të këtij ligji.

5. Mosparaqitja në Drejtorin përgjegjës për shërbimet postare dhe AKEP-ja, që të kryejnë funksionet e parashikuara në nenet 7 shkronja “e” dhe 7/1 shkronja “f” të informacioneve të nevojshme, që kjo e fundit të kryejë funksionet e veta të parashikuara në nenin 7 pika 9 të këtij ligji.

Neni 33

Masa e gjobës

(Ndryshuar pikat 2 dhe 3 me ligjin nr. 9223, datë 29.4.2004)

1. Kundërvajtjet administrative do të ndëshkohen krahas masave të parashikuara në nenin 18 pikat 3 dhe 4 të këtij ligji, me gjobë në masat si vijon:

a) Për kundërvajtjet administrative sipas nenit 32 pikat 1, 3 dhe 4, në masën pesë deri në dhjetë herë të shumicës së pagesës për marrjen përkatësisht të licencës individuale apo të licencës së përgjithshme.

b) Për kundërvajtjet administrative sipas nenit 32 pika 2, në masën dy deri në pesë herë të shumës së pagesës për marrjen, përkatësisht, të licencës individuale apo të licencës së përgjithshme.

c) Për kundërvajtjet administrative sipas nenit 32 pika 5, në masën dy herë të shumës së pagesës për marrjen përkatësisht të licensës individuale apo të licencës së përgjithshme.

2. Dënimi me gjobë dhe masa e saj vendosen nga inspektorët e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankimi, sipas parashikimit në pikën 7 të nenit 18 të këtij ligji.

3. Për zbatimin e kërkesave të këtij neni, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare bashkëpunon me organet përkatëse. Të ardhurat nga gjobat kalojnë në Buxhetin e Shtetit.

KREU IX

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 34

Mbështetja e shërbimit bazë

Shërbimi bazë postar, mbajtja dhe zhvillimi i tij sigurohen në rast nevoje edhe me mbështetje nga shteti në fushën investuese apo në dhënien e kredive me kushte lehtësuese.

Neni 35

Marrëdhëniet me pushtetin vendor

Në planet e zhvillimit bashkiak dhe rajonal, operatori publik i postave bashkëpunon me organet e pushtetit vendor për krijimin e mundësive për vendosjen e ndërtesave dhe të pajisjeve që i shërbejnë sigurimit të shërbimeve bazë, si dhe të lehtësive për reduktimin ose faljen e detyrimeve për përdorimin e hapësirave publike, detyrimin për vendosjen e kutive postare në ndërtesa dhe në vendbanimet private, si dhe administrimin e sistemit të adresave.

Neni 36

Përdorimi i simboleve

1. Operatori publik i postave do të caktohet ekskluzivisht për të përdorur emblemën e postës.

2. Operatori publik i postave, me miratimin e Ministrit, mund të urdhërojë përdorimin e uniformës nga punonjësit e vet.

Neni 37

Akte që shfuqizohen

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr.5841, datë 20.2.1979 “Për shërbimet postare dhe të telekomunikacioneve”, si dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore, që bien ndesh me dispozitat e këtij ligji, shfuqizohen.

Neni 38

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2454, datë 5.10.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani